

АРБАНОЛОШКИ СЕМИНАР


Инв. број

3910

Сигн.

C. 60 - n

~~E. 111/60 54~~



*eta*

*e pe*

ORGAN I LIDHJES SE SHOQNIVE KULTURO-ARSIMORE PËR KOSOVË E METOHI

---

VJETI VI

---

Kallinduer — Fruer 1954

---

NUMRI 1

---

## NJI SQARIM

Ju lutemi bashkëpunëtorëve që në polemitat e tyne të mos kalojnë në gjana personale si dhe tē jenë sa mā koncizë. Revista jonë âsht kryesisht letrare dhe shkrimet që drejtpërdrejt nuk janë tē këtilla, kanë vend tē kufizuem nē revistë — prandej do tē detyrohem i mos me i botue.

Redaksija

N'artikullin e tij „kritik“ nē numrin e kaluem tē kësaj reviste<sup>1</sup>) Selman Riza nē faqen 440 përmend edhe emnin tim, madjé n'atë mënyrë sa që unë, aq mā tepër si bashkëpuntuer i „Jetës së ré“, e ndjej nevojën që t'i përgjigjem personalisht. Dhe po i përgjigjem, si nē lidhje me mënyrën nē tē cilën ai, si pér rrëshqit dhe pa ndjenjë përgjegjësije më fyen, ashtu edhe përsa i përket pikëpamjeve tē tija shum tē gabueshëme nē çashtjet shkencore pér tē cilat bâ, fjalë.

1) Në sulmin e tij kundër prof. H. Bariqit, H. Kaleshit dhe H. Thaçit — pér tē cilët ai thotë se „kanë lidhë ndërmjet veti ndonjë kontratë tacite reklame reciproke“ — S. Riza gjuen baltë dhe mbi nji artikull tē shkruem bashkarisht nga unë e miku im Hilmi Thaçi<sup>2</sup>). Tue ja zanë pér tē madhe përgjithësisht Thaçit njifarë anësije, tē cilën ky gjoja e çfaqëka ndaj Bariqit, dhe tue ndeshë nē çmimin e volitshëm tē punës shkencore tē Bariqit edhe n'artikullin e përmendun, Riza thotë se ky artikull „vërtë nënshkruem edhe prej Dr. Ivan Popoviqit, por sigurisht stylizuem soll prej tjetrit...“<sup>3</sup>)“ dmth prej Thaçit, Natyrisht, z. Riza, i cili si shihet qartas nuk âsht linguist, vështirë që mund tē njofi aktivitetin tim nē fushën shkencore linguistike, albanologjike dhe joalbanologjike; por kjo gjâ atij kurrsesi nuk i jep kurrfarë tē drejte që — tue qenë i painformuem — tē tregojë dyshim, tē paargumentuem fare, se edhe unë mund tē kem ndaj disa problemeve qëndrimin tim, edhe sikur ky qëndrim tē përputhet me atë tē personave tjerë, e konkretisht nē këtë rast me qëndrimin e H. Thaçit. Fundi i fundit, fakti se H. Thaçi e unë e kemi nënshkruem së bashku atë artikull — nē tē vërtetë do tē thotë pikërisht se: pajtohe-

<sup>1</sup>) „Jeta e re“ Nr. 6, vj. 1953, dhe „Flaka e Villaznimit“ Nr. 283 fq. 9.

<sup>2</sup>) „Jeta e re“ Nr. 5, 1953: Norbert Jokli (1877-1942)

<sup>3</sup>) Të gjith nënvízimet janë tē mijat (I.P.)

mi në mendimet për të cilat bâhet fjalë. Me thanë mbas këtyne të gjithave, krejt arbitrarisht, se „sigurisht“ „soll“ Thaçi e ka stilizue të gjithë artikullin, kjo don me thanë me shqiptue nji pohim të paargumentuem, i cili në këtë rast, shì përkëtë, âsht dhe ofendues. Nga se, dhe për ç'arësyen S. Riza mendon se H. Thaçi ma ka imponue mendimin e tij, me fjalë tjerë se më ka bâ me nënshkrue me përdhunë, dhe të thuesh se m'a ka mbushë mendjen që edhe unë t'i bâj reklamë Bariqit?! Nji pohim i këtillë jo vetëm që âsht nji gjest i panjerëzishëm, jo i rëndomtë midis njerëzve që punojnë në lamën e shkencave, por, „a priori“ âsht jobindës dhe naiv, sepse prej tij del sikur unë, për albanologun, indoeuropeistin dhe romanistin e madh Henrik Bariqin, kam ndie prej Thaçit! Sikur të mos ishte Thaçi që të më bânte me dijtë për qenjen e Bariqit, unë as që do të kisha dijtë se ai egziston! Nuk mendoj me u futë në pohimet ofenduese të Rizës dhe, sidomos, në shprehjet — gjithashtu gjithmonë të paarsyetueme — drejtue kundër H. Bariqit, H. Kaleshit e H. Thaçit (sepse kjo âsht punë vehtjake e tyne); por mendoj se e gjithë kjo, kundrue në tanësi, hjedh dritë të shëmtueme në mënyrën dhe në sjelljen e Selman Rizës ndaj njerëzve të pendës.

Nga ana tjetër, në qarqet linguistike dihet se unë ç'prej shum vjetësh merrem *pikërisht me çashtje linguistike historike*, dhe albanologjike, dhe të tjera, kështu që, gjâ krejtësisht e natyrshëme, mendoj se edhe vogëlsija ime ka, dhe mund të ketë, ndonji mendim të vetin për çashtje të këtilla.

Nga sa u tha më nalt rezulton se — e këtë po e nënvizoj edhe nji herë — unë *pohoj mendimet e shprehuna n'atë artikull për të mijat* (sa edhe për të Thaçit). Ndërsa z. Riza le të jetë aq i njerëzishëm sa të më lejojë që në këto mendime të mbetem edhe më tutje — deri sa ndokush të mos më bindi *me argumente* se jam në lajthitje.

Kaq për „kurtoazin shkencore“ të Selman Rizës.

2) Po kaloj tash n'anën parimore shkencore. S. Riza ja sheh për të madhe H. Thaçit (kurse mue — ndoshta si endë të mitun? — më përjashton përdhunisht) po n'atë artikull pse, përbri Joklit (artikulli, në të vërtetë, i âsht kushtue Joklit „in memoriam“) gati vazhdimisht përmend Bariqin si shkencëtar për merita në linguistikën shqiptare. Riza thotë se Thaçi (kjo dmth. unë e Thaçi, me qenë se unë vetë nuk dëshiroj të përjashtohem nga kjo çashtje) ka marrë përkujtimin e Joklit vetëm si nji shkak për të lëvdue Bariqin, e Bariqin.

Kur Riza flet kështu, kjo don me thanë — po e thom haptas — se ai as që din se si âsht zhvillue dhe zhvillohet albanologjija. Me e thanë më troç, sikur z. Riza të mos kishte

shkrue me kaq bollëk, na as që do të merrshim vesh — sikundër e muerrëm — se ai nuk njeh historin e albanologjis (dmth. të linguistikës shqiptare). Me folë për Joklin (edhe për Pedersen) dhe mos me përmendë në të njajtën shkallë me ta edhe Bariqin do të thonte: mos me e njoftë historin e albanologjis, asgjâ mât mirë se sa e njef Riza. Sikur âsht thanë n'artikullin e përmendun me dy nënshkrime, tre janë emnat mât të dëjë në zhvillimin e linguistikës shqiptare bashkëkohore: *Pedersen, Bariq, Jokl*. Dhe këtë fakt tash âsht e pamundun me e ndërrue, madjë as për qejfin e lajthimeve të Rizës. Mue më duhet me shtue këtu edhe se (nuk dij për këtë gjâ çka mendon H. Thaçi, sepse këtë herë nuk jam konsultue me të!) në pikëpamje doktrinare, dmth. në pikëpamjen e tezave teorike albanologjike — Bariqi âsht madjë edhe mât i meritueshëm se Jokli. Ndërsa Jokli në radhë të parë âsht nji përpunues i shkëlqyeshëm i cili gjithmonë sillet në suazën e ideve (të sakta, s'ka dyshim) të Holger Pedersenit, Bariqi ka shkue mât tutje në rrugën e tij dhe ka dhanë pikëpamje teorike origjinale, të reja, në disa probleme të mëdha albanologjike. Në nji artikull kushtue përkujtimit të mbarimit tragjik të të ndjerit Norbert Jokl, nuk kishte vend me u zgjanue për këtë, prandej tash po e parashtroj shkurtas.

Ku âsht pra Bariqi novator i randësishëm në fushën e albanologjis, ku ka shkue ai përtej Joklit?

Së pari: Jokli qysh në shqyrtimin e materjalit gjuhësuar shqip, në „Grundriss-in“ e Streitberg-ut, ka mbetë në konceptin tradicional mbi lidhjen e gjuhës shqipe ndaj gjuhëve joklasike antike të Ballkanit, ilirishtes dhe thrakishtes. Ai këtu ende qëndron në pikëpamjen se Shqiptarët, qysh se mbahet mend, kanë qenë n'atdheun e tyne të sodshëm, dhe se gjuha shqipe âsht vetëm nji fazë e re e ilirishtes. Vetëm mbas kritikës studioze të Bariqit (Arhiv I) Jokli, n'artikujt e tij në „Reallexikon-in“ e Ebert-it, ka revidue qëndrimin e tij dhe çashtjen e kësaj lidhjeje e ka formulue kështu: gjuha shqipe âsht po aq e ngjajshëme me ilirishten sa edhe me thrakishten. Bariqi nuk âsht ndalue këtu, por âsht orvatë me përcaktue se cili âsht roli i ilirishtes dhe cili i thrakishtes në formimin e gjuhës shqipe. Në kundërshtim me konceptin e përmendun të Joklit, Bariqi ka parashtrue theorin se gjuha shqipe âsht *gjenetikisht* e ngjajshëme me thrakishten, dhe se ilirishtja ka qenë vetëm supstrakt (dmth. shtresë e vjetër). Mbës kësaj doktrine të Bariqit, edhe luftarët e vjetër t'origjinës së shqipes prej ilirishtes, si dhe vetë Pederseni, fillojnë gjithashtu t'orientohen në këtë drejtim. Edhe specialistët për çashtjet iliriane, nën ndikimin e argumenteve të Bariqit, fillojnë me e braktisë

konceptin mbi lidhjen e ilirishtes e të shqipes (p.sh. prîsat ilirologë gjermanë H. Krahe dhe J. Pokorny). Këtu qëndron aktiviteti i parë novator original i Bariqit.

Së dyti. Linguistika shqipe në të vërtetë ka dy aspektë: njani është indoeuropist dhe tjetri balkanologjik; dmth. ky i dyti studjon ndikimin reciprok të gjuhës shqipe, më nji anë, dhe të gjuhëve tjera të Ballkanit, fqîj me 'tê, n'anën tjetër. Lajthimin e vjetër të G. Meyerit se gjuha shqipe është nji gjuhë gjysëm romane e ka përbysë qysh nga fundi i qindvjetit XIX H. Pederseni dhe e ka dërmue krejtsisht romanisti W. Meyer — Lübke në botimin e dytë të „Grundriss-it“ të Gröber-it. Por Jokli në disa pikat ka mbetë në vijën e vjetër — atëherë kur gjurmonte elementet romane në gjuhën shqipe. Ai, këto elemente shqipe me prejardhje romane i vuni në të njajtën vijë me elementet romane pararomune dhe dalmatine. Përkundrazi Bariqi më 1937, në veprën e tij të randësi shëme „O uzajamnim odnosima balkanskih jezika,, I, ka argumentue se tanësi e këtillë ballkano-romane nuk ka egzistue, porse disa elemente romane të gjuhës shqipe përkojnë vetëm me ato të rumanishtes — kurse disa tjera vetëm me elementet dalmatino-romane. Tue shkue mbas Jireçek-ut, Jokli ka lokalizue atdheun e vjetër ballkanik të Shqiptarëve në Dardanë (në krahinën Nish-Shkup), kurse Bariqi ka tregue se ky ndikim i vjetër roman ndër Shqiptarët është i lidhun pikërisht për atë krahinë, në të cilën zakonisht konsiderohet se është formue rumanishtja dhe populli rumun. Mandej ka vërtetue se ajo shtresë më e re romane në gjuhën shqipe (natyrisht prap se prap më e vjetër se ajo italishte!) rrjedh prej asaj kohe kur Shqiptarët janë shpërndarë n'atdheun e tyne të rí, ku në dialektet e vjetra romane flitej nëpër qytete deri nga qindvjeti XIV (në Durrës, Lesh etj.) .Këto janë horizontet e reja të cilat i ka hapë Bariqi në lidhje me studimin e marrëdhanteve të gjuhës shqipe ndaj gjuhëve tjera historike ballkanike.

Së treti. Sllavisti rus Selishçev është përpjekë me argumentue se kur kanë ardhë Sllavët në Shqipnë, kanë hasë vetëm Romanët, e jo dhe Shqiptarët. Përkundrazi Bariqi, me analizimin e emnave gjeografikë, (krahaso psh. artikullin e tij në „Zbornik“ kushtue F. Ramovshit), ka argumentue se Shqiptarët kanë ardhë në këto vise disa shekuj më përpara. Këtë theori të Bariqit e kanë pranue sod edhe sllavistat. Ky pra është kontributi i tretë me randësi ku Bariqi, me anë të shkençës linguistike ka hudh poshtë kategorikisht thezën e gabue me të Selishçev-it.

Vërtetë, Riza „pohon“ meritën e Bariqit deri diku, dhe përmend ndonji prej studimeve të tija; përmend gjithashtu

edhe punën e tij organizative n' „Arhiv“<sup>1</sup>). Por ai, qartas për shkak mosnjohjeje nuk jep shënime të plota. Përndryshe, a do të guxonë vallë me harrue studimin aq të randësishëm të Bariqit mbi zhvillimin e pallataleve në gjuhën shqipe, pjesë e librit „Indoevropski palatali“ (Glas Srpske akademije CXXIV vj. 1927), mandej studimin klasik, tashmâ të përmendun mbi marrëdhjanjet reciproke të gjuhëve ballkanike (Biblioteka e „Arhivit“) etj? Si mund ta çmojë Riza Bariqin si albanolog kur të gjitha këto nuk i janë të njoftuna?

Mandej, âsht e qartë se edhe vetë „Arhivin“ e Bariqit, të cilit ai ja njeh meritën, Riza e njef vetëm „simbas të ndëgjue-mit“ ose mâ së shumti „nga pamja“. Sepse ai, sikur ta kishte lexue këtë, do të dinte para së gjithash se Bariqi nuk vepron n'Arhiv vetëm si nji grumbullues artikujsh t'auktoritetëve europjane në fushën e albanologjis, porse ai vetë, me pendën e tij të mprehtë kritike i ka dhanë gjithashtu — mund të thohet — *drejtimin dhe tonin albanologjis* në *përgjithësi* dhe ka qenë pra pikërisht nji auktoritet i atillë si sheh Riza në ndonji „Europjan“. Sikurse ta kishte lexue Riza „Arhivin“ e Bariqit, punimet tjera të Bariqit, mandej punimet e Pedersenit, Joklit dhe t'albanologëve tjerë (Weigand-it- Skok-ut, Meyer-Lübke-s, Tagliavini-t, Treimer-it, Çabejt, linguistave rumunë etj. etj.) ai të paktën nga ndonji herë duhej t'i citonte në punimet e tija të shumta e të stërgjana, në të cilat operon kaq serbez me etimologjina, dhe në të cilat aq me bollëk jep rezultate të gabueshëme e të stërvjetrueme, në shkencë tashmâ ç'me kohë të hjedhuna poshtë.

Mbi Rizën si etimolog mendoj të flas hollësishët dhe veçanisht më nji rast tjetër, dhe këtu vetëm do të përmendi disa shembuj t'etimologjimit të tij të gabueshëm, që të mos mundet me thanë se po flas përmendësh. Për Rizën psh. shq. *kumbar* âsht hua prej lat. *cumpátre* (që âsht fonetikisht e pamundshëme, për shkak të -tr-) dhe jo thjeshtësisht prej italishtes *compare*; shq. *mermer* për të âsht prej lat. *marmorem* e jo nëpërmjet të turqishtes *mermer*; shq. *vazhdim* ai e nxjerr prej sërbishtës *vazda*, e jo prej maqedhonishtes apo bullgarishës *vežda*, *veždža*, *važda* (që dmth. „vijë“); *apet* prej sërb. *opet* (që gjithashtu fonetikisht âsht e pamundshëme, për shkak të a-s) etj. etj.<sup>2</sup>

Me fjalë tjera: nga shkrimi i Rizës duket sikur ai, së pari s'ka haber për mbarë veprimtarin albanologjike të qindvjet. XX, dhe së dyti, sikur ai as që andrron se Bariqi — qoftë se, marrun subjektivisht, i vjen kujt mirë ose jo — âsht mâ i

<sup>1</sup>) „Jeta e re“ Nr. 6, vj. 1953 fq. 463.

<sup>2</sup>) shif „Fillimet e gjuhësisë shqiptare, Prishtinë, 1952 fq. 18,20,23.

madhi albanolog i gjallë, madjè sod i vetmi albanolog i madh (nuk mendoj këtu të harroj emnin e madh të Pedersenit, por Pederseni ç'prej dheta vjetësh nuk merret mâ me albanologjí). Ky âsht nji fakt, nji fakt kryeneç, dhe na nuk mund ta mo-hojmë vetëm se tue u dukë naivë dhe jo t'informuem. Në se pra Thaçi, dhe shkruesi i këtyne radhëve kanë thanë për Bariqin si albanolog se âsht *eminent* dhe se epoka n'albanologjí mund të quhet simbas tij (dhe Joklit) këtë ata e kanë thanë sepse *ashtu* âsht. Dhe me qenë se Bariqi (krahas me shkencëtarët tjerë) ka kaq merita për albanologjín, atëherë z. Riza nuk duhet të çuditet aspak që na „nja“ „dy“ e përmendim Bariqin.

M'e thanë troç, Selman Riza del këtu si ai mini, të cilin e kanë tallë sepse kur ka ndeshë në luanin, tue mos dijtë se luani âsht i madh e i fuqishëm, ka fillue t'ja brëjë bishtin.

Kaq për anën parimore t'asaj pjese „kritike“ të Rizës, në të cilën më prek dhe mue.

(Përk. A. Çetta)

Dr. Ivan POPOVIQ